



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 356/Prot.

Tiranë, më 13.05.2015

VENDIM

Nr. 33, datë 13/5/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi / Z. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 356 Prot., datë 23.04.2015, ndaj Autoritetit Publik/Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare". Ankuesi nëpërmjet shkresës datë 30.03.2015, ka kërkuar nga Prokuroria, *Kopje të dokumenteve të përdorura si provë materiale në procedimin penal ndaj shtetasve dhe* :

Ankuesi pretendon se kërkesa e tij nuk është trajtuar sipas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15/1 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", nga Autoriteti Publik. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, rezulton se Autoriteti Publik/Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat i ka kthyer përgjigje kërkuarit me datë 15.04.2015.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës së Z. , si dhe vendimit të mospranimit të kërkesës për informim të Prokurorisë së Shkallës së Parë Mat, të datës 15.04.2015, konstatoi se informacioni i kërkuar nuk mund t'i vihet në dispozicion kërkuarit pasi nuk përbën informacion publik në kuptim të nenit 2 pika 2 e ligjit 119/2015 "Për të Drejtën e Informimit". Gjithashtu duhet marrë në konsideratë fakti se, kërkuari nuk legjitimohet në kërkimin e tij, pasi nuk zotëron asnjë akt përfaqësimi të palëve në proces. Për këtë arsye dokumenti i kërkuar, në zbatim të nenit 17 pika 2 gërma b) dhe dh), të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", përbën një informacion i cili kufizohet nga ligji dhe nuk publikohet.

Në përfundim, në lidhje me ankesën e Z. , kundër Autoritetit Publik/ Prokurorisë Mat, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrezuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 356 Prot., datë 23.04.2015 të Z. _____, kundër Autoritetit Publik/ Prokurorisë Mat.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 13.05.2015.

